



Viti i XV-të i Botimit, Nr.2
Dhjetor 2023

NDIKIMI I FAKTORËVE FONETIKË NË FJALËFORMAT E GJUHËS SHQIPE

Gilberta Hadaj*

**Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Albanian University*

Përmbledhje

Fonetika, përmes theksit dinamik dhe proceseve të tjera, si: shkrirjes së tingujve, shtesave të tingujve, asimilimeve dhe të reduktimeve të llojeve të ndryshme ka luajtur një rol të dyfishtë: herë i ka bërë format morfologjike më të thjeshta, herë i ka bërë ato më të larmishme.

Ndërhyrjet fonetike shpesh kanë trazuar sistemin paradigmatic. Rrjedhojat e këtyre ndërhyrjeve janë kushtëzuar nga sistemi, por edhe nga natyra e morfemave gramatikore dhe e tingujve fundorë të temave. Në çdo pozicion qofshin, dy tinguj kufitarë nuk mund të shqiptohen njëllor siç shqiptohen ata më vete. Ndryshon shqiptimi i tyre, edhe kur ata shqiptohen në mes të fjalës a në fillim të saj. Shqiptimi i çdo çifti kufitar tingujsh ndryshon në varësi të llojeve të ndryshme të kombinimeve brenda fjalës. Por ndikimet dhe ndryshimet në tingujt kufitarë në fund të një fjalëforme janë të tjetër lloji. Aty tingujt janë më rezistentë edhe ndaj njëri-tjetrit, edhe ndaj përbërjes së formës përfaqësuese të fjalës në tërësi, falë vlerave gramatikore që kanë morfemat fundore përkatëse. Megjithatë edhe ata nuk janë të paprekshëm.

Ruajta e tingujve fundorë kufitarë apo ndryshimi i tyre është i kushtëzuar; edhe pasojat janë të ndryshme. Në rastin e ndikimit, pra të ndryshimit të tyre, ata përshtaten me njëri-tjetrin ose bashkëshkrihen. Në rastin e ruajtjes së tyre, kërkojnë mbështetje jashtëstrukturore. Ky do të jetë dhe objekti i punimit.

Fjalë çelës: *tinguj, fonetikë, gjuhë shqipe, fjalëformë*

THE IMPACT OF PHONETIC FACTORS ON THE WORD FORMS OF THE ALBANIAN LANGUAGE

Abstract

Phonetics, through dynamic accent and other processes, such as: sound melting, sound additions, assimilations and reductions of different types has played a dual role: sometimes it has made the morphological forms simpler, sometimes it has made them more diverse.

Phonetic interventions have often disturbed the paradigmatic system. The consequences of these interventions are conditioned by the system, but also by the nature of the grammatical morphemes and the final

sounds of the themes. In any position, two boundary sounds cannot be pronounced the same as they are pronounced separately. Their pronunciation changes, even when they are pronounced in the middle of a word or at the beginning of it. The pronunciation of each pair of sound boundaries varies depending on the different types of combinations within the word. But the effects and changes in border sounds at the end of a word form are different. There the sounds are more resistant both to each other and to the composition of the representative form of the word as a whole, thanks to the grammatical values that have the corresponding final morphemes. Even though are not invulnerable.

Preservation or change of final boundary sounds is conditional; even the consequences are different. In the case of impact, so their change, they adapt to each other or together they melt. In the case of their preservation, they require extra-structural support. This will be the object of this paper.

Keywords: *sounds, phonetics, albanian language, word form.*

Hyrje

Historia e njohur dhe e dokumentuar e gjuhës shqipe dëshmon se zhvillime dhe prirje të përgjithshme mund të shërbejnë për shpjeguar ç'ka ndodhur dhe ç'mund të ndodhë me fjalëformën e gjuhës shqipe. Në këto zhvillime duket qartë vija që ka ndjekur fjalëforma e shqipes. Shqipja, së paku nga çka duket dhe zhvillohet parasye tanë, tregon se ajo, përgjithësisht, shkon drejt tipit analitik. Treguesit karakteristikë të kësaj prirjeje janë: reduktimi i hershëm i sistemit lakimor në njëjës dhe njësimi i lakimeve në shumës; njësimi dhe reduktimi i strukturave morfologjike mbiemërore; njësimi i mjaft formave rasore përemërore; zgjerimi dhe përdorimi i mjaft formave analitike në sistemin foljor. Nga fjalëformimi, përbërja dhe përngjitja - të cilat rriten dhe shtohen gati për ditë - tregojnë shumë më qartë se rendi i fjalëve po bëhet më i qendrueshëm. Dhe dihet që ky proces morfo-sintaksor të çon detyrimisht në kufizim të eptimit.

Faktorët ndikues në ecurinë e fjalëformave të shqipes janë të ndryshëm. Kanë vepruar dhe vepronë faktorë fonetikë, por ndikim të madh kanë edhe faktorë të tjerë, si: trysia e sistemit morfologjik, ekonomia gjuhësore, analogjia, dënduria e përdorimit të fjalëve dhe të fjalëformave dhe në mjaft raste edhe faktorët sintaksorë. Të gjithë këta faktorë, të cilët vepronë herë së bashku dhe herë të veçuar, mbështetin ose kundërshtojnë eptimin e mirëfilltë, prandaj, në disa raste, vërehen edhe rikthime morfologjike ciklike.

Shembuj të bashkëshkrirjes së morfemave gramatikore me fundoret e temave vërehen gjatë zhvillimeve që kanë ndodhur në periudha të caktuara gjuhësore. Ndërsa, kur tingujt kufitarë mbeten të pandryshuar ose gati të pandryshuar, vepronë procese fonetike të tjera, si ndërputje e tingujve antihiatizues ose e zanoreve mbështetëse. Kurse, kur dy tingujt kufitarë mbeten të pandryshuar ose gati të pandryshuar, vepronë procese fonetike të tjera, si ndërputje e tingujve antihiatizues a ndërputje e zanoreve mbështetëse.[1]

1. Tingujt antihiatizues

Lloji i bashkëtakimit të tingujve, kushtëzon edhe llojin e tingujve që lehtësojnë këtë bashkëtakim. Kështu, kur vështirësitë krijohen ndërmjet zu zanoreve, atëherë tingulli i shtuar ndërmjet është një bashkëtingëllore. Për shqipen këto bashkëtingëllore janë: *j*-ja, *v*-ja dhe *h*-ja. Përgjithësisht, përdorimi i tyre lidhet me mënjanimin e hiatit, por shpesh ato e kanë kapërcyer këtë funksion fonetik fillestar, duke marrë, së bashku me mbaresat përkatëse, vlera të plota morfologjike. Në gjendjen e sotme, në strukturën e fjalëformës dallohen qartë funksione të diferencuara të këtyre tingujve. Kështu, bashkëtingëllorja *v*, e përfutur fillimisht si antihiatizuese në fjalëforma të veçanta, kur tema e fjalës mbaronte me zanore, sot është shtrirë te të gjitha llojet e temave të shumës, duke marrë kështu, bashkë me mbaresat rasore përkatëse të shumës, vetëm vlera morfologjike. [2]

| | | | | |
|-----------|-----------------|------------|------------------|------------|
| <i>Gj</i> | | <i>-ve</i> | | <i>-ve</i> |
| <i>D</i> | <i>(i) djem</i> | <i>-ve</i> | <i>(i) vajza</i> | <i>-ve</i> |
| <i>R</i> | | <i>-ve</i> | | <i>-ve</i> |

Kurse në sistemin foljor, në kryerën e thjeshtë, në vetën e parë dhe të dytë njëjës të mënyrës dëftore, pa varësisht se në koceptimin e sotëm merret si pjesë përbërëse e mbaresës përkatëse, *a*-ja e ruan edhe vlerën fonetike antihiatizuese, çka duket mjaft qartë, kur format përkatëse përqasen me vetën e tretë njëjës, ose me format përgjegjëse të foljeve që mbarojnë me bashkëtingëllore:

Dëftore

Koha e kryer e thjeshtë

Numri njëjës

| | | | | |
|---------------|-----------|-------------|------------|-----------|
| <i>V. I</i> | | <i>-v-a</i> | | <i>-a</i> |
| <i>V. II</i> | <i>pi</i> | <i>-v-e</i> | <i>hap</i> | <i>-e</i> |
| <i>V. III</i> | | <i>-u</i> | | <i>-i</i> |

Bashkëtingëllorja antihiatizuese *j*, përgjithësisht, shtrihet në sistemin emëror, ndonjëherë edhe në sistemin mbiemëror. Në këtë rast vlera antihiatizuese e saj ruhet, ashtu si edhe në përdorimin e *v*-së në këtë sistem, sepse ajo nuk shfaqet në gjithë sistemin paradigmantik emëror, por vetëm kur ndan dy zanore. Pra, vendoset vetëm kur temat emërore ose mbiemërore mbarojnë me zanore. Në rastet e tjera ajo nuk ndihet e nevojshme.[3]

Tek emrat

| | | | | |
|-----------|-----------------|-------------|--------------------|-----------|
| <i>Gj</i> | | <i>-j-e</i> | | <i>-e</i> |
| <i>D</i> | <i>(i) lule</i> | <i>-j-e</i> | <i>(i) kumbull</i> | <i>-e</i> |
| <i>R</i> | | <i>-j-e</i> | | <i>-e</i> |

Te mbiemrat

i ri

të re -ja

Si bashkëtingëllore antihiatizuese *j*-ja është pranuar edhe në sistemin foljor, por vetëm për vetën e tretë njëjës të lidhore për foljet që mbarojnë me zanore, si *të puno -j-* ë në përqasje me *të hap -ë*. Por, për ne, mund të jetë një interpretim i dyshimtë. Në këtë rast, nuk është e pamundur që - siç e kemi shpjeguar edhe më parë - veta e tretë njëjës e lidhore së kësaj klase foljesh të jetë formuar nga forma e vetës së parë e tematizuar *të punoj-* dhe mbaresa vetore përkatëse *-ë: të punoj - ë*.

Në përdorimet e tjera, *j*-ja mund të shpjegohet me zhvillime të tjera. Kështu, në urdhëroren e vetës së dytë njëjës te një grupi foljesh të zgjedhimit të parë, si: *shkruaj, lyej, laj* etj. *j*-ja vetëm burimisht lidhet me një tingull antihiatizues, sepse sot ajo nuk përfaqësohet më si e tillë. Në të vërtetë, ajo është një mbetje, si rrjedhojë e kushteve të fonetikës sintaksore, që sot gjen shprehje reale si antihiatizuese në

format e urdhërore të vetës së dytë njëjës të folje që mbarojnë me zanore dhe që ndiqen edhe nga një trajtë e shkurtër, si: *pi-j-e*, *ha-j-e* etj.

Tingulli antihiatizues *h* ndeshet vetëm në zgjedhimin jovepror të sistemit foljor. Në kushte fonetike të njëjta, në sistemin emëror kjo bashkëtingëllore nuk del. Megjithatë shtrirja e saj si një tingull me vlera antihiatizuese nuk besojmë se kushtëzohet nga kategoria leksiko-gramatikore. Ka të ngjarë që përdorimi i saj vetëm në sistemin foljor më shumë mund të lidhet me kohën e përfimit të kësaj gjendjeje. Në sistemin foljor *h*-ja si antihiatizuese duhet të jetë përdorur shumë më herët, prandaj në këto paradigma ajo nuk do të jetë ndier si bashkëtingëllore antihiatizuese, por si përbërëse e pandashme e mbaresave përkatëse. Dhe, në të vërtetë, bashkëtingëlloret antihiatizuese, siç thekson edhe S. Riza, "...përbëjnë një çfaqje të pamungueshme, e në përgjithësi të fiksuar me kohë..."[4]

Perceptimi si një mbaresë e vetme e bashkësisë *h* (si antihiatizuese) + *mbaresë* në paradigmen e zgjedhimit jovepror duket më qartë në përqasjen e dy përdorimeve të ngjashme. Kështu, kur një urdhëror përdoret me një trajtë të shkurtër, si tingull antihiatizues përdoret *j*-ja, kurse me një urdhëror të ndjekur nga pjesëza *u* e zgjedhimit jovepror, ndërhyjnë si tingull antihiatizues *h*-ja: *Pije ujin!* (*pi-j-e*) ~ *Lahu mire!* (*la-h-u*). Në rastin e dytë (*la-h-u*), bashkësia *-hu* perceptohet si një mbaresë e vetme, kurse në rastin e parë vlera antihiatizuese e *j*-së del më qartë. [5]

Këto lëkundje në përdorimin e tingujve të ndryshëm antihiatizues në të njëjtat kushte fonetike vërehen edhe në raste të tjera. Edhe përdorimi i antihiatizueses *v*, që del edhe në sistemin emëror, edhe në sistemin foljor, nuk kushtëzohet nga rrethana të njëjta fonetike. Kështu, në sistemin emëror në paradigmen e shumës si antihiatizuese shfaqet *v*-ja (*fusha-v-e* ...), kurse në paradigmen rasore të grupeve të caktuara emrash në njëjës del bashkëtingëlloret *j* (*lule-j-e*). Në këtë rast, kushtëzimet në përdorim janë të karakterit gramatikor. Përdorimi i *v* -së edhe në paradigmen e njëjësit, do të njësonte rasia të zhdrejta të njëjësit me ato të shumësit. Brenda paradigmes së njëjësit, i njëjti tingull antihiatizues *j*, ka sjellë pasoja të ndryshme. Kështu, në njëjës in e shquar tek emra femërorë, të cilët mbarojnë me zanoren *-e* të patheksuar, tingulli antihiatizues *j*, që del në emëroren e shquar, pasohet nga rënia e zanores fundore *-e*, kurse në rasia të zhdrejta, megjithëse është pësëri midis dy zanoreve, ajo vazhdon të ruhet. Ruajtja e *e*-së fundore në njërin rast dhe rënia në rastin tjetër, duket se lidhet me rrethanën që në trajtën e shquar në rasia të zhdrejta *j*-ja ndodhet midis dy zanoreve të njëjta, (*lule-j-e*), kurse në emëroren e shquar ndodhet midis dy zanoreve të ndryshme, midis zanores fundore *-e* dhe nyjës shquese *-a* (*lule -j-a* *lul-ja*). Por nuk është e pamundur që ky proces të lidhet edhe me karakterin e zanores *a* (nyjës përkatëse), e cila karakterizohet nga një hapje më e madhe e gojës sesa zanoret e tjera.

Duhet theksuar këtu që si tinguj antihiatizues përdoren vetëm bashkëtingëlloret shtegore *v*, *h* dhe *j*, të cilat kanë karakteristika të veçanta:

1. Përgjithësisht, nyjtimi i bashkëtingëlloreve shtegore zgjatet; kurse, brenda shtegoreve, bashkëtingëlloret antihiatizuese *v*, *h* dhe *j* kanë vlera të njëjta ose shumë të afërta gjatësie. Vlerat e gjatësisë së *v*-së dhe të *h*-së, p. sh. janë si vijon:

Vlera e gjatësisë së *v*-së: 100 (ms)

Vlera e gjatësisë së *h*-së: pak më shumë se 100 (ms)

2. Këto të dy bashkëtingëllore puqen edhe në shtrirjen e frekuencave të tyre:

Shtrirja e frekuencës së *v*-së: af.10000 (Hz)

Shtrirja e frekuencës së *h*-së: af. 100000 (Hz)[6]

3. Shtegu i nyjtimit është gati i njëjtë, prandaj edhe rryma e ajrit gjatë fërkimit formon një zhurmë gati të njëjtë.[7]

Megjithatë këto veçori akustike dhe nyjtimore, që i bashkojnë këto bashkëtingëllore, tregojnë vetëm një mundësi për funksione të njëjta, por nuk shpjegojnë edhe arsyen përse kryejnë pikërisht funk-

sionin e një tingulli antihiatizues. Do të ishte me interes që, përmes hetimeve laboratorike, të përcaktoheshin vlerat akustike dhe nyjtimore të gjithë bashkësisë tingullore treshe, të përfuar nga tingujt përkatës antihiatizues dhe zanoreve të tyre anësore në fjalëformat, ku ata ndeshen. Këto studime, dhe në përgjithësi studimet fonotaktike, i kanë munguar fonetikës dhe morfologjisë së shqipes.

3. Tingujt mbështetës

Me të njëtin funksion fonetik, si edhe tingujt antihiatizues, përdoren edhe tingujt mbështetës, të cilët nga autorë të ndryshëm janë quajtur tinguj “të shtuar” dhe “mbështetës” (Sh. Demiraj) ose tinguj “anaptikë”, “eufonik”, parazit”, “joorganik” apo “joetimologjikë (S. Riza). Prandaj edhe diferencimi në emërtim “antihiatizues” dhe “mbështetës” nuk lidhet kaq me funksioni sesa me natyrën fonetike të tingujve anësorë. Në shqipen e dokumentuar si tinguj mbështetës dalin *i*-ja, *u*-ja dhe *ë*-ja. Analizat dhe funksionet e këtyre tingujve, kryesisht në rrafsh diakronik, kanë qenë të pjesshme; jo të veçanta, por të ndërputura në analiza fjalëformash. Për sistemin emëror, vetëm S. Riza këtyre tingujve u ka kushtuar vëmendje të veçantë në veprën “Emrat në shqipe: Sistemi i rasave dhe tipet e lakimit”. Por analiza nuk është e plotë dhe kufizohet vetëm tek autorët e vjetër. Megjithatë, trajtimi aty ka vlera të dyfishta: ka vlerë e nismës dhe të thirrjes për studim; ka vlerë edhe për saktësinë dhe analizën e materialit konkret gjuhësor, të zgjedhur nga autorët e vjetër. Pavarësisht nga vendi i kufizuar që zënë këta tinguj në veprën e sipërpërmendur, autori ka përcaktuar disa rregulla e nënregulla të përdorimit të tyre në sistemin emëror. Për historinë e zhvillimit të kësaj dukurie, ka rendësi edhe përfundimi që zjerr autori se çrregullimet gjuhësore që vërehen në përdorimin ose mospërdorimin e tyre lidhen me “moskristalizimin gjuhësor” të anaptiksit dhe që, sipas tij, mund të shpjegohet me:

1. “risinë relative” të nyjavet të prapme në historinë e shqipes;
2. moshën jo të lashtë të vetë fenomenit të anaptiksit.[8]

Nëse në rastin e parë shpjegimi është i diskutueshëm; në rastin e dytë - shpjegimi është i vërtetë.

Nga shqipja e autorëve të vjetër dhe nga shpjegimet e S. Rizës deri sot, “çrregullimet” e hershme janë bërë rregull. Në shqipen standarde përdorimi i tingujve anaptikë rregullohet sipas normave të gjithëpranuara.

Përfimi i tyre i takon historisë së gjuhës;[9] në gjuhësinë e sotme ata janë shndërruar në përbërës të pandashëm morfemash. Përdormi a mospërdorimi i tyre në shprehjen e të njëjtave vlera morfologjike, formalisht ndërton edhe dyshen morfore të alomorfeve përkatëse. Kështu, në sistemin emëror shfaqen këto çifte morfesh, kun jëri prej tyre ka në përbërje një tingull mbështetës:

Në numrin njëjës

Në gjininë femërore :

-*ës* dhe -*s*, në gjinore-dhanore - rrjedhoren e shquar, si: *kumbull* -*ës* përballë *fushë* -*s*, *vegl* -*ës* përballë *liri* -*së* etj

-*ën* dhe -*n*, në kallëzoren e shquar, si: *kumbull* -*ën* përballë *fushë* -*n*, *vegl* -*ën* përballë *shtëpi* -*në* etj.

Në gjininë mashkullore:

-*in* dhe -*në* për kallëzoren e shquar, si: *djal* -*in* përballë *vëlla* -*në*;

Në gjininë asnjansore:

-*it* dhe -*t* në emërore dhe në kallëzore të shquar, si: të folur -*it* përballë të nxënë -*t*, të *ecur* -*it* përballë të *tënë* -*t* etj

Në numrin shumë

-ish dhe **-sh** në rrjedhoren e pashquar, si: *nxënës -ish* përballë *djem -sh*, *peshq -ish* përballë *miq -sh* etj.

-it dhe **-të/ t** për emëroren dhe kallëzoren e shquar, si: *nxënës -it* përballë *djem -të*, *peshq -it* përballë *miq -të* etj.

Në zhvillimin historik të sistemit foljor shfaqet e këtyre tingujve kanë qenë edhe të shpeshta, edhe të lëvizshme në formë dhe funksion. Në shqipen e sotme si të tillë shfaqen kryesisht **i**-ja dhe **ë**-ja. Por gjatë evolucionit të sistemit, si tingull mbështetës shpesh ka dalë edhe **e**-ja. Tingulli **e**, që fillimisht mendohet se ka dalë me funksionin e një tingulli mbështetës, në kushtet e rënies së mbaresës së hershme indoevropiane, ka marrë rolin e një mbaresë të mirëfilltë vetore. Kështu është shpjeguar, përgjithësisht, mbaresa e sotme e vetës së dytë njëjës **-e** e së kryerës së thjeshtë në zgjedhimin vepror (ti *hap -e*, ti *dol -e* etj.), që del edhe në përbërjen e mbaresave **-je** dhe **-ve**, përkatësisht në të pakryerën dhe të kryerën e thjeshtë (ti *puno -je* dhe *puno -ve* etj.). Mbaresa burimore indoevropiane e vetës së dytë njëjës për të pakryerën dhe të kryerën e thjeshtë ka qenë ***-t**, e cila nuk mund ta jepte asnjëherë **-e** në e sotme. Siç mendohet përgjithësisht, këtë rrugë duhet të kenë ndjekur edhe tinguj të tjerë gjatë zhvillimit historik të paradigmatave foljore. Kështu, me vlera të tilla fonetike në sistemin paradigmatic foljor duket se kanë dalë edhe **i**-ja dhe **ë**-ja, përkatësisht te format e vetës së dytë shumë në të tashmen e dëftores të zgjedhimit vepror te foljet në **-n** (*ban-i*) dhe te format e vetës së tretë të lidhore njëjës në të tashmen e zgjedhimit vepror (ai të *hap-ë*). Edhe në këto të dy raste, mbaresat vetore përkatëse indoevropiane, ***-tes** (për vetën e dytë shumë) dhe ***-ti** (për vetën e tretë njëjës), [10] nuk mund të jepnin as **-i** për vetën e dytë shumë në dëftore (*ban-i*), as **-ë**, për vetën e tretë njëjës në lidhore (ai të *hap-ë*).

Kështu që, përgjegjëset mbështetëse historike të tyre në shqipen e sotme janë reflektuar si mbaresa të mirëfillta vetore. Këto janë dukuri të vjetra, mjaft të hershme, ku nuk gjendet asnjë gjurmë e mbaresës burimorë. Shfaqja e këtyre tingujve me vlera fonetike mbështetëse del qartë në shqipen e re të dokumentuar. Te Meshari në paradigmen e shumësit mbaresat e vetës së parë dhe të tretë të së tashmes së dëftores dalin të zgjeruar me zanoren mbështetëse **-ë** (*ban j-ë- më ~ banj -ë -në*; *hap -ë -më ~ hap -ë -në* etj.); zanorja **-ë** fillimisht si zanore mbështetëse është shfaqur edhe në vetën e dytë të së tashmes së lidhore (*të hap -ë -sh*, *të dall -ë -sh* etj.) si dhe në të pakryerën e dëftores në tri vetat e shumësit (*hap-ë -m ~ hap -ë -t ~ hap -ë -në* etj.) Por këto fjalëforma dhe fjalëformat në përgjithësi, pas këtyre kombinimeve, marrin zhvillime të tjera edhe fonetike, edhe morfologjike. Në tërësinë paradigmatic foljore, të brendshme dhe të jashtme, tingulli mbështetës nuk formon opozicion më vete, por së bashku me mbaresën pasuese. Çka do të thotë se në çdo fjalëformë të paradigmes ai është shndërruar tani në një përbërës të domosdoshëm të një elementi gjuhësor morfologjik. Ky karakter morfologjik i **ë**-së në shëmbujt e sipërpërmendur vërtetohet përmes lehtësisë së zëvendësimit të tij me tingullin më shprehës **i**. Kështu, sot mbështetësja **-ë**, që dilte në format e mësipërme tek autorët e vjetër, është zëvendësuar me **i** (*hap -ë -më ~ hap -i -m ~ hap -ë -në ~ hap -i -n* etj.), duke i shndërruar mbaresat e reja **-im** dhe **-in** të së tashmes së dëftores (*hap -im ~ hap -in*) në forma të dukshme opozicionale në përfaqje me morfemat gjegjëse **-ëm** dhe **-ën** të së kryerës së thjeshtë (*hap -ëm ~ hap -ën*). Ky këmbim tani i **ë**-së me **i** në kushtëzohet nga arsye të karakterit morfologjik. Përdorimi i zanores së patheksuar **ë** si mbështetëse në shqipen e dokumentuar duket se është i ri dhe ka të ngjarë të lidhet me karakteristikat nyjetimore dhe akustike të saj e, në radhë të parë, me karakterin e hapur dhe sidomos me kohëzgjatjen. Zanorja **ë**, sipas ekperimentimeve akustike, është më e shkurtra në sistemin zanor të shqipes. [11]

Zanorja e vjetër **ë**, që sot del edhe si mbaresë e mirëfilltë, duhet të jetë refleksi i ndonjë zanoreje tjetër burimore, e cila është errësuar dhe duhet t'i ketë shpëtuar rënies pikërisht se prej kohësh ka marrë vlerën e një morfeme.

Pra, në të dyja sistemet, në sistemin emëror dhe foljor, janë kryesisht këto dy zanore që përdoren si mbështetëse, por ndër të dyja, gjithmonë ka paraprirë zanorja **ë**. Dhe, siç e kemi përmendur më lart, në disa raste, është **i**-ja më e re që ka zëvendësuar **ë**-në e vjetër. Përdorimi i **ë**-së në funksionin e një tingulli mbështetës nuk lidhet vetëm me karakteristikat akustike dhe nyjetimore në vetvete, por edhe me vlerat që

ka dhe që shton brenda një fjalëforme. Në përbërjen e çdo fjalëforme, zanorja e patheksuar ë, që përdoret me funksion mbështetës, duke qëndruar ndërmjet tingujve të tjerë, falë edhe kohëzgjatjes së kufizuar, ndihet më shumë si njësi bashkuese e jo si një njësi fonetike e mëvetësishme. Megjithatë këmbimi i mbështetëses ë me *i*-në në sitemin emëror ndryshon nga i njëjti këmbim në sistemin foljor. [12] Në sistemin foljor, gjatë ndërrimit, zanorja *i*, krahas bartjes së funksionit fonetik mbështetës, i jep formës foljore përkatëse edhe vlera shtuese morfologjike formëdalluese. Kurse tingulli mbështetës *i* në sistemin emëror mbetet si e tillë në çdo rast ndërrimi. Ky dallim mbështetet edhe në rrethanën që, në raste të veçanta, në sistemin emëror ky zëvendësim nuk ia ndërron vlerat thjesht fonetike tingujve përkatës. Kështu, këmbimi i fundores së temës –ë me tingullin mbështetës *i*, që vihet re tek emrat foljorë, nga *të nxënë –t* në *të nxën –i –t*, nuk luan rol morfologjik, por thjeshtë fonetik. Këmbimi dhe përdorimi i zanores mbështetëse *i* në vend të ë –së, ka vlerë fonetike më shprehëse, por nuk lidhet me ndonjë nevojë morfologjike. [13]

Përfundime

Lloji i bashkëtakimit të tingujve, kushtëzon edhe llojin e tingujve që lehtësojnë këtë bashkëtakim. Kështu, kur vështirësitë krijohen ndërmjet dy zanoreve, atëherë tingulli i shtuar ndërmjet është një bashkëtingëllore. Për shqipen këto bashkëtingëllore janë: *j*-ja, *v*-ja dhe *h*-ja. Përgjithësisht, përdorimi i tyre lidhet me mënjanimin e hiatit, por shpesh ato e kanë kapërcyer këtë funksion fonetik fillestar, duke marrë, së bashku me mbaresat përkatëse, vlera të plota morfologjike.

Me të njëtin funksion fonetik, si edhe tingujt antihiatizues, përdoren edhe tingujt mbështetës, të cilët nga autorë të ndryshëm janë quajtur edhe tinguj “të shtuar” dhe “mbështetës” ose tinguj “anaptikë”, “eufonik”, “parazit”, “joorganik” apo “joetimologjikë”. Prandaj edhe diferencimi në emërtim “antihiatizues” dhe “mbështetës” nuk lidhet kaq me funksioni sesa me natyrën fonetike të tingujve anësorë. Në shqipen e dokumentuar si tinguj mbështetës dalin *i*-ja, *u*-ja dhe ë-ja.

Përfimi i tyre, përgjithësisht, i takon historisë së gjuhës, sepse në gjuhësinë e sotme ato janë shndërruar në përbërës të pandashëm morfemash. Përdorimi i këtyre tingujve në përbërjen e mbaresave, ndërton njëherësh edhe seritë e morfeve të alomorfeve përkatëse.

Pra, në të dyja sistemet, në sistemin emëror dhe foljor, janë kryesisht këto dy zanore që përdoren si mbështetëse, por ndër të dyja, gjithmonë ka paraprirë zanorja ë. Në disa raste është *i*-ja më e re që ka zëvendësuar ë-në e vjetër. Përdorimi i ë-së në funksionin e një tingulli mbështetës nuk lidhet vetëm me karakteristikat akustike dhe nyjetimore në vetvete, por edhe me vlerat që ka dhe që shton brenda një fjalëforme. Në përbërjen e çdo fjalëforme, zanorja e patheksuar ë, që përdoret me funksion mbështetës, duke qëndruar ndërmjet tingujve të tjerë, falë edhe kohëzgjatjes së kufizuar, ndihet më shumë si njësi bashkuese e jo si një njësi fonetike e mëvetësishme. Megjithatë këmbimi i mbështetëses ë me *i*-në në sitemin emëror ndryshon nga i njëjti këmbim në sistemin foljor.

Në sitemin foljor, gjatë ndërrimit, zanorja *i*, krahas bartjes së funksionit fonetik mbështetës, i jep formës foljore përkatëse edhe vlera shtuese morfologjike formëdalluese. Kurse përdorimi i mbështetëses *i* në sistemin emëror mbetet si e tillë në çdo rast ndërrimi. Ky dallim mbështetet edhe në rrethanën që, në raste të veçanta, në sitemin emëror ky zëvendësim nuk ia ndërron vlerat thjesht fonetike tingujve përkatës.

Kështu, këmbimi i fundores së temës –ë me tingullin mbështetës *i*, që vihet re tek emrat foljorë, nga *të nxënë –t* në *të nxën –i –t*, nuk luan rol morfologjik, por thjeshtë fonetik. Këmbimi dhe përdorimi i zanores mbështetëse *i* në vend të ë –së, ndodh për arsye fonetike më shprehëse; pra, ky zëvendësim nuk e ndërron vlerën morfologjike të fjalëformës.

Referenca:

1. Agalliu F., Angoni E., Demraj Sh., Dhrimo A., Hysa E., Lafa., Likaj.,(2002), “Gramatika e gjuhës shqipe 1”, Academy of Sciences of Albania, Tirana.
2. Bokshi B., (2010) Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes, Prishtinë,
3. Buchholz O.; (1987) Fiedler W., Albanische Grammatik,
4. Demiraj Sh.,(1975),” Sistemi i lakimit në gjuhën shqipe”, pp.189;
5. Demiraj Sh.,(1986), “Gramatikë historike e gjuhës shqipe”
6. Domi M.,(1961), “Morfologjia historike e shqipes” (Dispense), Tirana.
7. Likaj E., (1977), “Disa çështje të zhvillimit historik të nyjave në gjuhën shqipe”,pp 4,31;
8. Likaj E., Çabej M, (2010), “Morfologji e shqipes standarde”, Tirana.
9. Tichy Eva., (2004) *Indogermanistisches Grundwissen*, Germany, f.87
10. Likaj E., (2005) Fleksioni indoevropian, Tiranë
11. Likaj E., Hadaj G., (2019), “Ndikime në fjalëformat e shqipes”, Academy of Sciences of Albania, Tirana.
12. Likaj E.,(2003), “Zhvillimi i eptimit në gjuhën shqipe” (Historical Morphology), Tirana.
13. Likaj E.,(2015),” Zhvillime të mjeteve gramatikore të shqipes”,Tirana.
14. Lloshi Xh., (2011) Shqipja, gjuhë e hapur dhe dinamike, Tiranë
15. Lyons J., (2001), “Hyrje në gjuhësinë teorike”, Tirana.
16. Mansaku S.,(1980/2) Ndërtimet me foljen ndihmëse kam + paskasjore tek autorët e vjetër, SF
17. Memushaj R.,(2012), “ Morfonologjia e eptimit të shqipes standarde”, Tirana.
18. Riza S.,(1982), “Probleme të nyjave të shqipes”, pp.2, Tirana.
19. S. M. Metev and V. P. Veiko,(1998) Laser Assisted Microtechnology, 2nd ed., R. M. Osgood, Jr., Ed. Berlin, Germany: Springer-Verlag, 1998.
20. Hadaj G., (2022) “Impact of Phonetic Factors on the Word Forms of the Albanian Language” International Conference on Research in Education and Science, 71-75
21. Hadaj G., Tahiri A., (2023) “Themes of grammatical forms in the nominative system” *Anglisticum. Journal of the Association-Institute for English Language and American Studies*, 36-42
22. Hadaj, G., & Tahiri, A.. (2023). Morphological Homonymy in the Verbal Structure of the Albanian Language. *Migration Letters*, 21(2), 1–7. <https://doi.org/10.59670/ml.v21i2.5845>
23. Hadaj, G., & Tahiri, A.. (2024). “Emojis, widely used in modern communication” *The International Journal of Learner Diversity and Identities* Volume 30, Issue 2, 2023, <http://ijldi-cgrn.com/> © Common Ground Research Networks Published by Common Ground Research Networks. Attribution License, (CC BY 4.0). ISSN: 2327-0128 (Print), ISSN: 2327-2627 (Online)
24. Hadaj, G., & Tairi, A. (2023). THEMES OF GRAMMATICAL FORMS IN THE NOMINATIVE SYSTEM. *ANGLISTICUM. Journal of the Association-Institute for English Language and American Studies*, 12(6), pp.36–42. <https://doi.org/10.58885/ijllis.v12i6.36gh>